



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1524/4 prot.

Datë 21.07.2022

V E N D I M
Nr. 679/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.07.2022, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr. 1524 prot., datë 14.07.2022 për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-32732-06-13-2022 me objekt Loti 2 “Blerje automjete 4x4 për transport punonjës sigurie në eskortë”, me fond limit 15.611.112 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Blerjeve të Përqëndruara.

Ankimues: Operatori ekonomik “Alto” SHPK
Autorstrada Tiranë – Durrës, Km 5, Rr.Monum, Nr.58, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Agjencia Shtetërore e Blerjeve të Përqëndruara
Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nd.1, 1001, Tiranë

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”; Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020, datë 05.11.202 “Rregullore për marrjen e masave organizative për

ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 14.06.2022, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-32732-06-13-2022 me objekt Loti 2 “Blerje automjete 4x4 për transport punonjës sigurie në eskortë”, me fond limit 15.611.112 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Blerjeve të Përqëndruara.

II.2. Në datën 14.07.2022, operatori ekonomik ankimues “Alto” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar skualifikimin e tij në procedurën e mësipërme të prokurimit. Bazuar në nenin 112, pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi në datën 15.07.2022 arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues.

II.3. Në datën 18.07.2022, operatori ekonomik ankimues “Alto” SHPK, me anë të shkresës protokolluar me tonën me nr. 1524/3 prot., datë 18.07.2022, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje

me procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-26604-04-26-2022 me objekt Loti 2 “*Blerje automjete 4x4 për transport punonjës sigurie në eskortë*”, me fond limit 15.611.112 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Blerjeve të Përqëndruara.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues “Alto” SHPK për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-32732-06-13-2022 me objekt Loti 2 “*Blerje automjete 4x4 për transport punonjës sigurie në eskortë*”, me fond limit 15.611.112 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Blerjeve të Përqëndruara, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankesë dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës nr. 1524 prot., datë 14.07.2022 për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit "*Procedurë e Hapur*", me Nr. REF-32732-06-13-2022 me objekt Loti 2 "*Blerje automjete 4x4 për transport punonjës sigurie në eskortë*", me fond limit 15.611.112 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Blerjeve të Përqëndruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohe të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "Alto" SHPK.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

